



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura e VIII  
Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere  
Mbledhja nr. 03/21  
Prishtinë, më 28.4.2021, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Verica Qeraniq, Yllëza Hoti, Jeta Statofci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti, Pal Lekaj dhe Duda Balje.

Mungoi : Bedri Hamza.

Pjesëmarrës të tjerë: Ismet Krasniqi, sekretar i përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu, drejtor i përgjithshëm i administratës në Kuvendin e Kosovës dhe Istret Azemi, drejtor i Buxhetit.  
Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Muja, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më 14.4.2020;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020;**
- 4. Votimi i Buxhetit të Komunës së Mitrovicës për vitin 2021;**
- 5. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar - mars 2021;**
- 6. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën prill - qershor 2021;**
- 7. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

**Armen Muja**, kryetar, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më 14.4.2020;**

Kryetari konstatoi se u miratua procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 14.4.2020.

### 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020;

**Armend Muja, kryetar,** i ftoi përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës që ta paraqesin Shqyrtimin e raportit vjetor të shpenzimeve. Në bazë të Ligjit të buxhetit 2021 të Kuvendit, janë alokuar 11.155.000 euro dhe pas rishikimit të buxhetit kjo shumë ka rënë në 10 milionë euro dhe përfundimisht buxheti i Kuvendit ka qenë 8.651.000 euro. Buxheti i shpenzuar ka qenë 93.35%, në të gjitha kategoritë, përjashtuar investimet kapitale.

**Ismet Krasniqi, sekretar,** paraqiti raportin vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020. Administrata për shpenzimet buxhetore raporton në periudha të rregullta tremujore. Buxheti fillestar i Kuvendit ka qenë 11.155.000 euro, në rishikim kanë dalë në 3.155.000 euro, një shkurtim i dyte i radhës ka ndodh për 388.000 euro dhe shkurtimi i tretë për 970.000 euro, dhe në total kemi mbetur me 8.651.000 euro. Sipas kategorive, buxheti është shpenzuar te pagat 99.98%, te mallrat dhe shërbimet 84.27%, te shpenzimet komunale 94.31%, te subvencionet 96.89%, te shpenzimet kapitale 18.50%. Arsyeja te shpenzimet kapitale ndodhi për shkak pandemisë një numër i projekteve të parapara nuk mundën të realizohen në shumën e paraparë, por në rishikim është bërë edhe shqyrtimi i mjeteve, dhe kemi mbetur tek shpenzimi i parave të mbetura diku 18.50 %. Mirëpo, gjatë dhjetorit disa pagesa që kanë mbetur gjatë viti 2020, na janë paraqitur nga thesari se janë shtyrë për vitin 2021.

**Pal Lekaj,** pyeti në lidhje me raportin e Kuvendit, se a kanë kontrata për shërbime të veçanta, sa është numri i punëtorëve dhe a kanë kontrata të përhershme dhe tha se e ka studiuar raportin dhe e ka parë se 80% e buxhetit shkon në paga .

**Ismet Krasniqi, sekretar,** duke iu përgjigjur pyetjeve të deputeti Lekaj, theksoi se janë 193 shërbyes civilë, 120 deputetë, ndërsa 75 janë staf mbështetës politik. Numri i përgjithshëm i punëtorëve të punësuar është 415. Sa i përket kontratave, i gjithë stafi kanë aktemërimë të përhershme. Kuvendi i Kosovës prej vitit 2008, nuk ka asnjë kontratë mbi vepër .

**Mërgim Lushtaku,** theksoi se Ligji për zyrtarët e lartë publikë e ka pamundësuar pjesën e rekrutimit. Si keni vepruar ju? Pjesa punëtorëve të Kuvendit ka qenë 190 punëtorë, pse janë shtuar 214. Sa i përket raportit të Kuvendit në përgjithësi është i përgatitur mirë. Raporti na është dërguar i skanuar, por nuk shihet asgjë në material. Në digjitalizim administrata ka investuar mjaftë mjete dhe ka një progres të mirë. Tek pjesa e shpenzimeve, buxheti, pavarësisht të TIK-ut është 0%, por pse nuk u realizuan disa procedura të Kuvendit në aspektin e digjitalizimit, WIFI.

**Ismet Krasniqi,** theksoi se sa i përket çështjes së punëtorëve, ne kemi pasur të drejtën e rekrutimit të 14 zyrtarëve shtesë në mungesë të platformës elektronike, kemi qenë në pritje nga Qeveria që të sjellë platformën se si të bëhet rekrutimi në pjesën elektronike. Tek pjesa e TIK-ut, punëtorët që kanë kontaktuar me operatorin për vlerësimin e TIK-ut kanë qenë të atakuar me Covid 19, kjo ka ndodhur në muajin korrik dhe në gusht. Kur kemi kontaktuar me operatorin, ai na njoftoi se stafin e ka të atakuar me covid, kështu që muaj me vonë, në shtator dhe tetor, me pajtimin e operatorit kemi kontaktuar KRPP-në dhe kemi kërkuar të vazhdojë kontrata me operatorin dhe nuk ka pasur pagesë për punët e pakryera.

Ai i përmendi disa punë që janë kryer në Kuvend, por që nuk është bërë pagesa. Krijimi i qendrës të së dhënave, punët janë përfunduar sipas kontratave, por nuk iu është bërë pagesa, për krijimin e

sistemit WIFI puna është kryer në vitin 2020, por nuk është bërë pagesa. Te projekti i ndërtesës janë bërë pagesat në bazë të punëve të kryera, projekti i liftit ka mbetur papaguar meqenëse nuk është bërë funksionalizimi i tij, projekti i sistemit Trados me vendim të Qeverisë është shkurtuar .

**Mërgim Lushtaku**, pyeti për Kodin e shërbimeve intelektuale këshillëdhënëse me rastin e Ligjit të buxhetit apo ndonjë ligji tjetër, kur kemi nevojë për ekspertizë. Asnjë ekspert nuk pranon të vijë për 20 euro. A ka ndonjë rregullore të veçantë për të ndryshuar sepse një ekspert nuk pranon të vijë për një pagesë ditore. Më mirë do ishte që të rregullohet ose që të rritet buxheti në mënyrë që të krijohen mundësi më të mira për angazhimin e ndonjë ekspert.

**Ismet Krasniqi**, tha se me Ligjin për zyrtarët publikë, angazhimi i ekspertit kërkon procedurë të prokurimit dhe aktualisht është një udhëzim për shfrytëzimin e mjeteve për këshilla profesionale, dhe ai është në fuqi. Krasniqi theksoi se si të bëhet ndonjë iniciativë nga kryetarët e komisioneve për ta ndryshuar udhëzimin dhe të ndjekim procedura tjera që të bëhet angazhimi i një eksperti, do ta ndjekim. Nuk ka asnjë kërkesë nga komisionet parlamentare, dhe buxheti është për ekspert në bazë të nevojave që kanë komisionet parlamentare .

**Jeta Statovci**, pyeti se në kuadër të shpenzimeve, është një kategori ku thuhet “qiraja për ndërtesë” nëse mund ta sqaroni për çfarë qiraje bëhet fjalë?

**Ismet Krasniqi**, theksoi se “Agjencia për ndihmën Shtetërore” e themeluar tash tre vjet nga Kuvendi i Kosovës e sistemon me qira. Ai tha se është dhënë një konstatim që të përcillet në kodin e administratës. Do të ishte një mundësi që kjo agjenci të shpallet e pavarur, vendosjen e saj në administrim e ka për detyrë bordi e jo administrata. Kuvendi nuk ka hapësira edhe për këtë agjenci. Ju kisha sugjeruar se, që ju të bëni më të mirën e mundshme, që ta sistemoni këtë agjenci të pavarur.

**Eman Rahmani**, pyeti në lidhje me numrin e të punësuarve dhe se ne këtë shifër, sa keni ju të punësuarve (415), a është e përmbushur kuota e punësimit të punëtorëve me aftësi të kufizuara dhe sa është numri i këtyre peronave?

**Ismet Krasniqi**, tha se me kuotën e punësimit sipas Ligjit me aftësi të veçanta e kemi plotësuar, por nuk do të thotë se nuk do te angazhojmë prapë punëtorë me aftësi të kufizuar. I kemi 7 punëtorë të tillë dhe jemi të gatshëm që në çdo rekrutim që pason, të rekrutojmë edhe kandidatë me aftësi të kufizuar.

**Eman Rrahmani**, shtoi se në këtë numër prej 415, ju bie t’i punësoni 8 veta me aftësi të kufizuar, pra në 51 punëtorë, i bie një me aftësi të kufizuar, kështu që në te ardhmen shpresoj që të jeni shembull si Kuvend i Kosovës në këtë pikë .

**Ismet Krasniqi**, sqaroi se 120 deputetë dhe 70 të tjerë janë staf politik, që do të thotë se nuk janë punëtorë të rregullt, kurse 193 janë shërbyes civilë ndërsa ne i kemi angazhuar 7 punëtorë me aftësi të kufizuar.

**Yllëza Hoti**, pyeti në lidhje me shpenzimet e vendimeve të gjykatave dhe tha se është një rritje e madhe prej viti të kaluar 130.740 euro, nëse ka mundësi na tregoni pse?

**Ismet Krasniqi**, në lidhje me shpenzimin për vendimet e gjykatave, tha se Kuvendi në vitin 2014 ka qenë palë procedurale. Ne procesin e gjatë që ka ndodhur në vitin e kaluar na është imponuar pagesa për këtë procedurë në tri shkallë gjyqësore. Bëhet fjalë për pajisjet elektronike edhe sipas

procedurës se prokurimit i kemi shikuar, nuk na janë ofruar pajisjet që i kemi kërkuar. Nga 130 që i kemi kërkuar, ne i kemi pranuar 116, ndërsa gjykata ka nxjerrë vendim në favor të palës tjetër.

**Kryetari** pyeti lidhur me rekomandimet e auditori se a ka pasur ndonjë vërejtje dhe cilat kanë qenë masat që i keni marrë ju?

**Ismet Krasniqi**, tha se Kuvendi i Kosovës me buxhetin që e posedon, është shpallur një ndër agjencitë me përgjegjëse buxhetore. Sa i përket auditorit të jashtëm, jam mirënjohës për punën që e kanë bërë me vite të tëra. Sa i përket rekomandimeve, kanë qenë 4 sish dhe janë të zbatuara.

**Kryetari** pyeti lidhur për pjesën e mbetur nga viti të kaluar, se a keni bërë kërkesë për bartjen e mjeteve për vitin aktual?

**Ismet Krasniqi**, tha se kemi bërë kërkesën të punët e papërfunduara që kanë mbetur, po, edhe janë pjese e buxhetit.

**Kryetari** theksoi se Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, miraton raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës dhe konstatoi se komisioni ka votuar me shumicë votash .

Pas përfundimit të diskutimeve, komisioni nxori këtë:

### **Rekomandim**

Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit që të miratojë **Raportin e shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2020** .

#### **4. Votimi i Buxhetit të Komunës së Mitrovicës për vitin 2021;**

**Armend Muja, kryetar**, tha se e kemi proceduar buxhetin e Komunës të Mitrovicës për vitin 2021 dhe vetëm ka mbetur që ta votojmë .Po ashtu kërkoi falje nga deputetja Verica Ceranic për dokumentet që i'u kane dërguar me vonesë.

**Verica Čeranić**: Faleminderit Kryesues, sa i përket email-ave, nga dita kur kam dhënë vërejtjen, email-at arrijnë në kohë, mbrëmë pak vonë e kam marr email-in rreth orës 22:30, por dokumentet ishin të përkthyer në gjuhën serbe, vetëm të pjesa e buxhetit për komunën e Mitrovicës, e kam shikuar këtë pjesë sepse thuhet që miratohet buxheti për komunën e Mitrovicës, kështu që pyetja ime është se cili buxhet për cilën komunë, sepse nuk po shoh që po respektohet Ligji për Kufijtë Administrativë të Komunave nr. 03/L-041, në nenin 5 ku thuhet se komuna e Mitrovicës është e përbërë nga dy pjesë, pjesa jugore dhe veriore e Mitrovicës, sepse edhe vitin e kaluar por edhe këtë vit kur është fjala për buxhet, qëndron vetëm Mitrovica, dhe nuk është siç duhet të jetë në përputhje me këtë ligj nr. 03/L -041, ju faleminderit.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, i rekomandon Ministrisë së Financave që dokumenti i buxhetit për Komunën e Mitrovicës, që ka ardhur përmes Qeverisë dhe Kuvendit, të bëhet pjesë e tabelave buxhetore të Ligjit mbi ndarjen buxhetore të Republikës së Kosovës 2021. Ai konstatoi me shumicë votash, i rekomandon Ministrisë së Financave që ky buxhet që është me vonesë, të hyjë në Ligjin për buxhet

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni nxori këtë:

## Rekomandim

Të miratohet Buxheti i Komunës së Mitrovicës për vitin 2021 dhe të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

### 5. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar - mars 2021;

**Armend Muja, kryetar**, theksoi se RTK-se ia kanë dërguar një listë me pyetje të cilën e ka kthyer por nuk pati kohë të mjaftueshme për t'u përkthyer në gjuhën serbe. Janë përkthyer, mirëpo me vonesë ju kanë dërguar deputetes.

**Visar Korenica**, për pyetjet e bëra RTK-së lidhur me shpenzimet e mbeturinave është në raport se është paguar prej një punëtori, i cili është dënuar, ku kanë shkuar mjetet edhe a është dënuar apo dënim formal?

**Ngashnjim Kastrati, drejtor** iu përgjigj pyetjes së parashtruar dhe tha se ai vendim i gjykatës për personin në fjalë është dënuar, i është konfiskuar pasuria dhe është larguar nga puna se në raportin kur e kemi sjellë e kemi paraqitur si borxh. Ky është rast i viti 2008.

Në vitin e kaluar kemi pasur një marrëveshje me një kompani pastrimi për pagesën e borxheve. Kompania ka bërë vërejtje dhe ka kërkuar që t'i tërheq të gjitha mjetet dhe borxhin e mbetur, mirëpo kemi kërkuar që te na shtyhet kësti deri me tash, që të ndahen mjetet.

**Visar Korenica**, pyeti se a janë ngrirë xhirollogaritë bankare apo jo dhe si ka shkuar çështja deri te përmbaruesi?

**Ngadhnjim Kastrati**, tha se rasti ka qenë në gjykatë, por ne kemi bërë marrëveshje tek përmbaruesi, në mënyrë që mos ta paguajmë kamatën, kjo ishte marrëveshja. Sa i përket çështjes se a janë ngrirë xhirollogaritë bankare, ato nuk janë ngrirë sepse nuk kemi pasur mjete në llogarinë e RTK- së.

**Armend Muja, kryetar**, pyeti se në bazë të Ligjit të RTK-së, RTK- ja i raporton Kuvendit në baza periodike dhe vjetore për llogaritë financiare, në përputhje me procedurat e përcaktuara me Ligjin për Financat Publike, neni 33. A jeni të vetëdijshëm sa i përket këtij provizioni ligjor në Ligjin për RTK?

**Salih Bashota**, për këtë pyetje të z.Muja, theksoi se raportet e RTK-së janë transparente edhe në ueb faqen tonë. Ne bëjmë raporte mujore, vjetore të punës e kështu me radhë. Ne kemi raportuar ne bazë të ligjeve të Rregullores së RTK-së, sa herë që kemi qenë të ftuar në komisione.

**Kryetari**, theksoi se sipas Ligjit të RTK-së dhe nenit 26.7, Bordi shqyrton edhe miraton buxhetin vjetor dhe për pagat e menaxhmentit. Shpenzimet e RTK- së nuk tejkalojnë burimet e tyre financiare dhe buxheti do të jetë dokument publik. Në vitin 2018 ka pasur një shumë prej 5 milion euro borxh. A mendoni se lejimi i tejkalimeve të vazhdueshme, bordi e ka shkelur Ligjin e RTK-së?

**Salih Bashota**, theksoi se nuk e kam shkelur ligjin, sepse ato borxhe kanë qenë të trashëguara dhe janë përcjellë me vite. Çdo shifër që është paraqitur në raport të vitit 2020 dhe 2021, bordi është në mbikëqyrje të plotë dhe menaxhmentit. Unë e përgëzoj këtë menaxhment sepse ka bërë kursime të jashtëzakonshme dhe një pjesë e madhe e borxheve, janë paguar.

**Kryetari**, theksoi se nëse ju nuk e keni shkelur ligjin, atëherë bordi paraparak e ka bërë këtë.

**Salih bashota**, tha se bordi i kaluar i ka pasur kompetencat e tij ligjore, të cilat i ka zbatuar. Unë ju përgjigjem vetëm prej periudhës kur e kam marrë mandatin, që ligjin nuk e kemi shkelur, por secili nga ne kemi përgjegjësi.

**Ngadhënjim Kastrati, drejtori RTK-së**, theksoi se me ligj e kemi obligim që të marrim vepra të autorëve të jashtëm, por 90% , ne i mbajmë programet në RTK, ne po flasim për vitin 2020 dhe 2021. Unë e potencova se në vitin 2018 kemi një borxh prej 5 milion eurove. Kur e kemi dorëzuar raportin në mars të vitit 2021, e kemi borxhin prej 2.750.000 eurove, që është zvogëluar dhe se deri në fund të këtij viti, borxhi i RTK-së do të bjerë për 1 milion euro. Ne po synojmë që borxhi i mbetur deri në fund të vitit të jetë 1.5 milion euro.

**Eman Rrahmani**, tha se u cek për bordin e mëhershëm, ka qenë përgjegjës për këto shpenzime të cilat i ka tejkaluar të hyrat. Në raportin e 3 mujorit shihet se edhe ky bord i ka tejkaluar shpenzimet, në krahasim me të hyrat, është në rrugën e njëjtë.

**Salih Bashota**, tha se nuk flas për kompetencat e tyre, unë them se flas vetëm kur e kam marrë mandatin si kryesues i Bordit të RTK-së dhe nuk i ka tejkaluar shpenzimet që janë brenda vijës buxhetore të viti 2021. Ne e planifikojmë buxhetin, por vjen diçka e paparashikueshme për shkak të vet procesit të punës që ka mbetur sepse ato nuk varen vetëm nga bordi dhe nga menaxhmenti, por nga indikatorë të tjerë. Kjo është mënyra e menaxhimit, kodi buxhetor me kodin tjetër, por duke pritur edhe kontrata që nënshkruhen e vonohen pagesat.

**Halil Bajramaj**, theksoi se sa i përket pyetjes suaj lidhur me borxhet e trashëguara, ato janë krijuar në momentin që ndërpritet një kontratë, për atakimet për Gjykatën Kushtetuese ka qenë 30 shtatori vitit 2009. Në vitin 2010 është ndarë buxheti prej 10 milionë e gjysmë euro, ndërsa në vitin 2011, na janë ndarë 2 milion e gjysmë më pak. Procedurat e prokurimit kanë vazhduar duke përfunduar punën në bazë të buxhetit që është dorëzuar në Kuvend, por është zvogëluar përnjëherë buxheti për 2 milion e gjysmë dhe prej këtu është borxhi i trashëguar.

**Visar Korenica**, pyeti se sa ka qenë shuma që keni paguar në këtë vit?

**Halil Bajrami**, theksoi se kemi një llogari bankare që na lejohet edhe me hy në minus. E mjetet në llogari kanë qenë 50.000 euro, me marrëveshjen me Kuvendin, thuhet se duhet të hapim një llogari në njëren bankë komerciale, ai ka ofruar një ofertë, ne e kemi përdorë overdrafte. Ne, vitin e kaluar e kemi mbyllur me 400.000 euro më pak se shpenzimet.

**Kryetari**, tha se ka pasur tejkalim të shpenzimeve, jo vetëm në vitin 2012, mirëpo edhe në vitin 2014 dhe vitin 2015, përjashtimisht në vitin 2020, ku ka pasur një plus prej 421 mijë. Gjithashtu, që nga viti 2012, shpenzimet në paga dolën jashtë kontrollit. Shpenzimet në mallra, shërbime dhe investime kapitale janë ulur, ndërsa shpenzimet në paga janë rritur vazhdimisht.

**Pal Lekaj**, tha se çdo tejkalim i buxhetit nëse nuk e ka arsyeshmërinë e vet, është shkelje e ligjit,

mirëpo, ju nuk e keni bërë këtë, dhe gjithashtu duhet këtë arsye shumë të madhe ta tejkaloji buxhetin dhe pyeti Bordin, në cilën kategori të shpenzimeve janë krijuare borxhet paraprake. Specifikisht, në mallra, subvencione, investime kapitale, apo blerje? A është paraparë ky borxh, që të jetë në Ligjin për Buxhetin për RTK, me një shumë të caktuar, që të aprovohet dhe të mos të merreni me këtë temë çdo herë.

**Ngaddhënjim Kastrati, drejtori i RTK-së,** *tha se ka rritje pagash në vitin e fundit, mirëpo jo për shkak të punësimit, mirëpo, për shkak që rregullorja e parasheh që pas çdo viti të rritet rroga e punëtorëve, deri në 1.5% ose në bazë të performancës.* Ndërsa në kategorinë që më së shumti janë krijuar borxhet, janë investimet kapitale, mallra dhe shërbime, kryesisht sepse aty hyjnë programet, të drejtat e sportit etj.

**Visar Korenica,** pyeti se **cili nen ju lejon që të bëni mbitërheqje të parave në bankë, dhe kush ju ka autorizuar ta bëni këtë.**

**Menaxhmenti i RTK-së,** theksoi se tash 13 vite ekziston kjo llogari bankare. Banka Komerciale ka dhënë një ofertë, dhe Bordi i kaluar e ka aprovuar atë. Kjo është arsyeja pse kemi vepruar në këtë mënyrë.

**Kryetari,** pyeti se **a është miratuar projeksioni i Buxhetit 2021, dhe a e keni miratuar raportin 3 mujor të shpenzimeve në Bord?**

**Kryetari i Bordit,** tha se **e konfirmoj që e kemi shqyrtuar dhe miratuar projeksionin buxhetor të vitit 2021, gjithashtu edhe raportin 3 mujor të shpenzimeve.**

**Kryetari,** tha se në raportin 3 mujor ka mospërputhje mes projeksionit dhe raportit buxhetor. Disa kategori të shpenzimeve nuk janë paraparë fare. Gjithashtu në raport janë shtyrë disa shpenzime që ndryshojnë vlerën.

Gjithashtu, në kuadër të raportit 3 mujor na mungojnë disa informacione si : Sa është raporti i të hyrave të kategorive gjatë 3 mujorit të parë, raporti i shpenzimeve të 3 mujorit të parë, raporti i shpenzimeve krahasuar me alokim buxhetor, shpenzimet në projekte kapitale, raporti i deficitit, një raport mbi pasurinë monetare dhe numri i kontratave për shërbime të veçanta dhe numri i punëtorëve.

**Kryetari i Bordit të RTK-së,** tha se pajtohem me kryetarin që raporti duhet të ketë përputhje të plotë në projeksionin buxhetor, dhe personalisht mendoj që ka përputhje të plotë, përjashtimisht ndonjë gabim të vogël.

**Drejtori i RTK-së,** gjithçka që është e paraqitur në projeksionin buxhetor është e paraqitur në raportin 3 mujor. Për sa i përket pyetjes, disa manifestime janë shty për shkak të pandemisë, si Lojërat Olimpike, Euro 2020. Gjithashtu, disa emisione që nuk janë të përmendura me emër, janë të paraqitura si emisione edukative, kulturore ose dokumentar, varësisht nga natyra e emisionit, dhe jo nga emri i tyre.

**Eman Rrahmani,** tha se numri i të punësuarve në RTK është rreth 1.009 punëtorë. Sa është numri i personave me aftësi të kufizuar, duke marrë parasysh se është detyrë ligjore që numri i personave me aftësi të kufizuar duhet të jetë 1 në 50?

**Ngaddhënjim Kastrati, drejtori i RTK-së:** “Më duhet ta konfirmoj këtë gjë për ta dhënë një përgjigje konkrete, mirëpo besoj që numri i të punësuarve me aftësi të kufizuar është afër 10 persona.

**Jeta Statovci**, tha se në rajon zakonisht 30-40% e buxhetit të televizionet publike shkon në paga, ndërsa tek RTK-ja, 71% e buxhetit ndahet për paga, gjithashtu RTK-ja ka 208 punëtorë me kontrata në shërbime të veçanta, a respektohet 120 ditshi që duhet të kenë këto kontrata?

**Ngadhënjim Kastrati**, tha se sigurisht që respektohet, shumica e këtyre personave nuk angazhohen as 120 ditë, mirëpo, 120 ditë është maksimumi i angazhimit të tyre.

**Kryetari**, tha se sipas nenit 15, kontratat që i mundëson ose ofron mbajtjen e kompensimit, duhet t'i nënshtrohet procedurave të tenderimit, ndërsa sipas informacioneve, RTK I i ka dhënë të drejta satelitore kompanisë "Artmotion" pa tenderim publik, a është e vërtetë kjo?

**Ngadhënjim Kastrati**, tha se për momentin nuk kam përgjigje për këtë pyetje, mirëpo do t'iu përgjigjem në momentin kur të kamë një përgjigje konkrete.

**Visar Korenica**, duke marrë parasysh se në rajon bordet publike, paguhen rreth 400-500 euro, në RTK, Bordi e ka caktuar vetë pagën 1000+ euro, në bazë të çfarë parametrave e keni vendosur këtë pagë? Gjithashtu, pyeti kryetarin e bordit nëse ende qëndron përgjigjja e njëjtë rreth të punësuarit të një familjari për shërbim, gjatë kohës kur është emëruar kryetar i bordit.

**Salih Bashota, kryetari i Bordit të RTK-së**, tha se sa i përket pyetjes së parë, paga nuk është mbi 1000 euro, dhe gjithashtu vendimi ka qenë i njëjti, ende pa u emëruar unë kryetar i Bordit. Ndërsa, për pyetjen e dytë, përgjigjja është e njëjtë. Personi i përmendur ka qenë i punësuar dhe nuk është më.

**Visar Korenica**, pyeti për arsyet e uljes së të hyrave të RTK-së, nëse është në plan zvogëlimi i punëtorëve, dhe a do të ketë shkurtim të buxhetit për paga nga 70% , së paku të bie në 50%?

**Ngadhënjim Kastrati, drejtor i RTK-së**, tha se arsyeja e uljes të të hyrave, është për shkak të marketingut që është shpërngulur më shumë në rrjetet sociale, ndërsa për sa i përket zvogëlimit të të punësuarve, qëllimi i RTK-së është të punësojë, dhe ta rritë cilësinë gjithnjë e më shumë.

**Kryetari**, tha se në bazë të ligjit, votimi për pagën tënde, është konflikt interesi. Si shpjegohet fakti që Bordi, ka vendosur që t'ju rritet paga Bordit të RTK-së?

**Salih Bashota**, tha se këtë gjë nuk e kam votuar unë, ky është një vendim që është ndërmarrë para se të jemë pjesë e këtij Bordit, dhe unë vetëm e kam trashëguar, prandaj nuk kam përgjigje konkrete.

**Kryetari**, konstatoi se raporti është miratuar me vërejtje. Të gjitha vërejtjet me shkrim t'i dërgohen Thesarit dhe Ministrisë të Financave, dhe raporti i ardhshëm tëjetë sipas formatit të ri, mbi Ligjin për menaxhimin e financave publike.

#### **4. Shqyrtimi i programeve të shpenzimeve të RTK për prill -qershor 2021;**

**Kryetari i Bordit të RTK-së** tha se e kemi dërguar raportin për periudhën prill-qershor, me sqarime shtesë, dhe të gjitha planet e detajuara, shpenzimeve që parashikohen në buxhetin e RTK-së për vitin 2021 janë në përputhje me vijat buxhetore

**Kryetari**, tha se ky projeksion për prill-qershor, a është në përputhje me projeksionin e dërguar Kuvendit?



**Salih Bashota**, theksoi se sigurisht që është në përputhje.

**Pal Lekaj**, pyeti auditimi që është bërë në vitin 2020, a është i kualifikuar, apo i pakualifikuar, dhe sa çështje i ka të theksuara.

**Ngadhënjim Kastrati, drejtori i RTK-së**, tha se auditimi është i pakualifikuar, dhe nuk ka asnjë çështje të theksuar.

**Eman Rrahmani**, pyeti se a keni bërë ndonjëherë auditim të performancës në RTK?

**Ngadhënjim Kastrati**, tha se nuk kemi bërë asnjëherë, mirëpo auditori është i lirë që të vijë në bazë të ligjit, pa ndonjë pengesë.

**Avdullah Hoti**, tha se duhet të kemi kujdes që ta ruajmë balancën e mosndërhyrjes në punën e RTK-së, mirëpo, duke kërkuar raportim në detaje, se a po shpenzohen këto mjete që po i ndajmë në përputhje me ligjet në fuqi?

**Visar Korenica**: “ Në shpenzimet e paraqitura për këtë periudhë është edhe mirëmbajtja e veturave ku kostoja e saj është përafërsisht 29.300 euro. Cila është arsyeja e kostos kaq të lartë, dhe sa është numri i veturave që i përdorni?”

**Ngadhënjim Kastrati**: “ Këto vetura janë me qira, të cilat përdoren nga RTK-ja, Radio e RTK2 . Numri i veturave është 16, mirëpo janë edhe disa të tjera që janë në pronësi të RTK-së”.

**Visar Korenica**, pyeti për mundësinë e parapagimit, kur ka hy në fuqi Ligji për RTK-në, është kërkuar që në afat prej 6 muajve Bordi i RTK-së bashkë me menaxhmentin të propozojë mënyrën e financimit me parapagim, a keni të dhëna që menaxhmenti paraprak është marrë me këtë dhe a është propozuar në Komision për Buxhet dhe Financa?

**Ngadhënjim Kastrati**: “Sipas informatave të mia, ligji ka kaluar në lexim të parë, ku është paraparë mundësia e financimit me parapagim, mirëpo, ka kaluar vetëm në lexim të parë, dhe jo në të dytin.

**Kryetari**, tha se duke marrë parasysh që Bordi paguhet 150.000 euro në vit nga taksat e qytetarëve të Kosovës, a keni marrë ndonjë iniciativë që të pavarësohen nga ne.

**Salih Bashota**, kryetari i Bordit të RTK-së: “ Po kemi pasur iniciativa, si në vitin 2019, ashtu edhe në vitin 2020, mirëpo, asgjë s'ka lëvizur deri më tash. Mirëpo, kërkoj ndihmë edhe nga ju si Komision, gjithashtu edhe nga Komisioni për Media dhe Kuvendi, sepse është në të mirë të përgjithshme, në mënyrë që të rritet edhe besueshmëria dhe cilësia e televizionin publik.

**Kryetari**, kërkoi që me kusht të rekomandohet që të bëhet alokimi i (TRANSH-it 2) me kushtin që kur të vjen grupi punues ta formatizojë projektionin sipas linjave të Ligjit të Buxhetit. Kryetari e hapi votimin.

Kryetari konstatoi që me shumicë votash është miratuar projektioni i shpenzimeve prill-qershor 2021, me kushtet që do të përcaktohen nga një grup i përbashkët pozitë-opozitë, për formatin njësimin e projeksioneve financiare, dhe sinqeritetin në raportim.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni, nxori këtë:

### VENDIM

1. Komisioni miratoi Programin e Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën prill - qershor 2021, në shumë prej 2,800,000 euro (dy milion e tetëqind mijë euro).
2. Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit në Ministrinë e Financave, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në buxhetin e
3. Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr. 11101219060187, për periudhën prill - qershor 2021, në shumë prej 2,800,000 euro (dy milion e tetë qind mijë euro).
4. Komisioni vëren se në kuadër të projeksioneve buxhetore prill-qershor 2021, ka shpërputhje me Projektionet 2021, të miratuara në kuadër të Ligjit për Ndarje Buxhetore. Komisioni rekomandon organizatën që të bëhet njësimi dhe harmonizimi i këtyre projeksioneve para raportimit të radhës në Kuvend.
5. Raportimi financiar për periudhën prill-qershor, duhet të jetë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e financave Publike, Neni 41 dhe Udhëzimet për Raportim Financiar nga Organizatat Buxhetore (01/2017) dhe Udhëzimi për Shpenzimin e Parasë Publike (01/2013). Raporti i shpenzimeve duhet të ketë këto të dhëna: bilancin, raport i shpenzimeve reale për periudhën tremujore – në kuadër të shpenzimeve inkuadrohen edhe shpenzime të detyrimeve nga vitet paraprake, raporti i shpenzimeve krahasuar me strukturën e buxhetit të alokuar, shpenzimet reale në projekte kapitale, shpenzimet reale në mallra dhe shërbime, raporti i deficitit/suficitit gjatë kësaj periudhe, pagesat për gjoba dhe shpenzime gjyqësore, llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme, donacionet e jashtme dhe raporti i detyrimeve kontingjente.
6. Raportimi financiar i radhës duhet të inkorporojë edhe të dhënat e shpenzimeve të standardizuara sipas formatit të ri të raportimit edhe për periudhën janar-mars 2021.
7. Komisioni nënvizon që shpenzimet për periudhën prill-qershor duhet të respektojnë udhëzimet e Ligjit për Menaxhim të Financave Publike dhe nuk mund të përdoren për shpenzime të detyrimeve paraprake pa aprovim të ndryshimeve në Projektionin 2021.
8. Komisioni rekomandon që shpenzimet e parasë publike të jenë në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloret e organizatës buxhetore.
9. Komisioni rekomandon që shpenzimet e parasë publike të jenë në përputhje me Ligjin e Punës 03/L – 12.

#### **7. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime për këtë pikë të rendit të ditës.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:45**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit**

**Armend Muja ,**

**Kryetar i Komisionit,**

---